



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 26, datë 20.1.2021

P Ë R

**PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN  
E RINDËRTIMIT/RIKONSTRUKSIONIT TË OBJEKTEVE ARSIMORE  
NË BASHKITË KAMZË DHE KAVAJË DHE ÇAKTIMIN E TYRE  
SI NJËSI ZBATUESE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "i" dhe "iii", 16 dhe 36, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr.137/2020, "Për buxhetin e vitit 2021", me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit/rikonstruksionit të objekteve arsimore në bashkitë Kamzë dhe Kavajë, në masën 1 223 429 959 (një miliard e dyqind e njëzet e tre milionë e katërqind e njëzet e nëntë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH, sipas detajimit të mëposhtëm:
  - a) Bashkisë Kamzë, në masën 754 430 842 (shtatëqind e pesëdhjetë e katër milionë e katërqind e tridhjetë mijë e tetëqind e dyzet e dy) lekë pa TVSH, për:
    - i. rindërtimin e shkollës 9-vjeçare "Niko Hoxha", në masën 189 845 078 (njëqind e tetëdhjetë e nëntë milionë e tetëqind e dyzet e pesë mijë e shtatëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH;
    - ii. rindërtimin e çerdhes "Kamzë", në masën 67 638 407 (gjashtëdhjetë e shtatë milionë e gjashtëqind e tridhjetë e tetë mijë e katërqind e shtatë) lekë pa TVSH;

- iii. rikonstrukcionin e shkollës së mesme “Ibrahim Rugova”, në masën 178 500 000 (njëqind e shtatëdhjetë e tetë milionë e pesëqind mijë) lekë pa TVSH;
- iv. rikonstrukcionin e shkollës 9-vjeçare “Ahmet Zogu”, në masën 163 800 000 (njëqind e gjashtëdhjetë e tre milionë e tetëqind mijë) lekë;
- v. rikonstrukcionin e shkollës 9-vjeçare “Kamza e Re”, në masën 66 780 000 (gjashtëdhjetë e gjashtë milionë e shtatëqind e tetëdhjetë mijë) lekë;
- vi. rikonstrukcionin e kopshtit “Kamza e Re”, në masën 30 170 000 (tridhjetë milionë e njëqind e shtatëdhjetë mijë) lekë;
- vii. rikonstrukcionin e kopshtit “Ahmet Zogu”, në masën 57 697 357 (pesëdhjetë e shtatë milionë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e treqind e pesëdhjetë e shtatë) lekë.

b) Bashkisë Kavajë, në masën 468 999 117 (katërqind e gjashtëdhjetë e tetë milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e shtatëmbëdhjetë) lekë pa TVSH, për:

- i. rikonstrukcionin e shkollës së mesme “Aleksandër Moisiu”, në masën 153 041 206 (njëqind e pesëdhjetë e tre milionë e dyzet e një mijë e dyqind e gjashtë) lekë pa TVSH;
- ii. rikonstrukcionin e shkollës “Qamil Xhani”, në masën 139 632 943 (njëqind e tridhjetë e nëntë milionë e gjashtëqind e tridhjetë e dy mijë e nëntëqind e dyzet e tre) lekë pa TVSH;
- iii. rikonstrukcionin e shkollës 9-vjeçare “Razi Leka”, në masën 119 025 106 (njëqind e nëntëmbëdhjetë milionë e njëzet e pesë mijë e njëqind e gjashtë) lekë pa TVSH;
- iv. rikonstrukcionin e kopshtit “Hap pas hapi”, në masën 57 299 862 (pesëdhjetë e shtatë milionë e dyqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e dy) lekë pa TVSH.

2. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për vitin 2021, për financimin e rindërtimit/rikonstrukcionit të objekteve arsimore në bashkitë Kamzë dhe Kavajë, në masën 244 685 991 (dyqind e dyzet e katër milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e një) lekë pa TVSH, i cili përballohet nga shpenzimet e fondit të rindërtimit dhe detajohet, si më poshtë vijon:

- a) Bashkisë Kamzë i transferohet fondi në masën 150 886 168 (njëqind e pesëdhjetë milionë e tetëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar;

- b) Bashkisë Kavajë i transferohet fondi në masën 93 799 823 (nëntëdhjetë e tre milionë e shtatëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e njëzet e tre) lekë pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar.
3. Caktimin e bashkive Kamzë dhe Kavajë si njësi zbatuese për financimin e rindërtimit/rikonstruksionit të objekteve arsimore, sipas pikave 1 dhe 2, të këtij vendimi.
4. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe bashkitë Kamzë e Kavajë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

**K R Y E M I N I S T R I**

**EDI RAMA**

**Në mungesë dhe me porosi**

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI**

**ERION BRAÇE**

**MINISTRI I SHETIT  
PËR RINDËRTIMIN**

**ARBEN AHMETAJ**

NR.PROT. 371/I  
DATE 21. 1. 2021

MINISTRIT TË SHTETIT PËR RINDËRTIMIN  
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË  
BASHKIVE KAMZË DHE KAVAJË  
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGAÇI

A blue circular official stamp is positioned over the signature. The stamp contains the text "MINISTRI I SHTETIT" at the top and "REPUBLICA E SHQIPËRISË" at the bottom, with a central emblem.